Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

1. Shërbimi i Ruajtjes dhe i Sigurimit Fizik kërkohet të kryhet për 17 (shtatëmbëdhjetë) objekte të institucioneve të varësisë Bashkisë Elbasan. Shoqëria e sigurisë të marrë përsiper ruajtjen, parandalimin e vjedhjeve, dëmtimeve të materialeve dhe të objekteve në administrim të Bashkisë Elbasan.
2. Sh.P.S.Fizik të kryhet në zbatim në Ligjet 75/2014, 74/2014 si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre me armatim, uniformë, pajisje ndërlidhje dhe mjet transporti. Organizimi i shërbimit të bëhet me plan skicimi e dislokimi në vendosjen dhe shtrirjen e shërbimeve .Në çdo vëndshërbim të ketë libër shërbimi për marrjen dhe dorëzimin e detyrës me instruktazhin e nevojshëm nga Drejtuesi Teknik i Shoqërisë.
3. Punonjësit e shërbimit të jenë të certifikuar konformë Ligjit 75/2014, gjatë ushtrimit detyrës punonjësi të jetë i pajisur me uniformën, shenjën dalluese, emblemën, stemën e shoqërisë, dokumentin identifikues si dhe pajisjet personale si shkop gome, hekura lidhës, rrip multifunksional, konformë Udhëzimit të MB nr.157, datë 01.04.2015 "Për funksionimin e Shpsf", si dhe të kenë kontrata pune me operatorin ekonomik.
4. Të sigurojë 2(dy) grupe të gatshme me punonjës shërbimi në mbështetje të njësive të shërbimit (nga 1 grup shërbimi kryesisht për turnet e II-ta dhe të III-ta) për ndërhyrjen dhe parandalimin e rasteve të ngjarjeve.Grupi i shërbimit të jetë i pajisur me uniformë, armatim me autorizimin e përdorimit, ndërlidhje, automjet me logon e shoqërisë si dhe pajisje të tjera speciale për ndërhyrje në raste emergjence.
5. Shërbimi në njësit e shërbimit në terren do të kryhet nga punonjësit e shërbimit të pajisur me uniformë, armatim me autorizimet e përdorimit në vëndshërbim të punonjëve, me radio-komunikimi dore si dhe pajisje të tjera të percaktuara në aktet nënligjore.
6. Të vërë në dispozicion për sigurimin e objekteve,institucioneve të varësisë bashkisë, qendrën e kontrollit,të pajisur me sistem ndërlidhje, radiokomunikimi, radioalarmi dhe të ofrojë shërbim/monitorimi 24 orë për menaxhimin e shërbimit.
7. Të mbulojë të gjitha shpenzimet si detyrimet fiskale, paga e rojeve , sigurimet shoqërore të personelit të punësuar nga ana e tij për ruajtjen e objekteve , shpenzimet për uniformat, armatime, ndërlidhje si dhe gjithë kompesimet e tjera të njohura me ligj.
8. Kontraktori mban përgjegjësi për dëmtimet apo vjedhjet që mund të ndodhin në objekte që ruhen nga ana e tij, kur këto vijnë si rezultat i moskryerjes me korrektësi të shërbimit apo

mungesës së vigjilencës të rojeve, dhe që vërtetohet nga organet kompetente. Në këtë rast kontraktori detyrohet të bëjë çdëmtimin 100% të vlerës së dëmtuar.

Detyrat e punonjësit shërbimit:

- Punonjësi i shërbimit do të kryej shërbim sipas planizimit të shërbimit në libërin e shërbimit dhe instruktazhin e nevojshëm nga Drejtuesi Teknik i Shoqërisë.
- Punonjësi i shërbimit të komunikojë me transparencë, etikë dhe konform kërkesave të ligjit me qytetarët, eprorët dhe me çdo autoritet ligjzbatues, kur kërkohet një gjë e tillë;
- Punonjësi i shërbimit të ruajë në gjendje funksionale mjetet e ndërlidhjes e ndriçimit, si dhe pajisjet e tjera të dhëna për përmbushjen e detyrës;
- Punonjësi i shërbimit të mbajë, sipas rregullores, armatimin personal në detyrë të miratuar nga Policia Shtetit, si dhe të përdorë armën sipas legjislacionit në fuqi;
- Punonjësi i shërbimit të zbatojë me korrektësi detyrat për ruajtjen e objekteve dhe të mbajë lidhje të vazhdueshme me eprorët e vet dhe këta të fundit me drejtuesit e institucioneve.
- Punonjësi i shërbimit të kryejë detyrat për ruajtjet e vendit të ngjarjes në territorin e shërbimit, të bëjë identifikimin e personave që lidhen me ngjarjen dhe të vihet në dispozicion të strukturave të Policisë së Shtetit për hetimin e ngjarjes në objektin që siguron; të japë informacionin e mundshëm në funksion të kryerjes së detyrave të Policisë së Shtetit; të vihet në dispozicion të strukturave të Policisë së Shtetit, sa herë që kërkohet, për parandalimin e veprave penale dhe zbulimin ngjarjeve të ndodhura në mjedisin ku kryen detyrën ose në ato të lidhura me detyrën;
- Punonjësi i shërbimit, para marrjes së shërbimit, kontrollon objektin në prezencë të rojes dorëzuese dhe për mangësit e konstatuara njofton përgjegjësën e rojeve dhe atë të objektit, duke bërë shënimet përkatëse në librin e shërbimit. Punonjësi i shërbimit për marjen e detyrës sipas grafikut duhet të paraqitet 15 min. para. Punonjësi i shërbimit nuk duhet të largohet nga vendi i kryerjes së shërbimit pa u zëvendësuar dhe pa marrë miratimin e përgjegjësit të shërbimit.
- Të lejojë kontrole të autorizuara me shkrim nga drejtuesit e institucionit në objektet që janë në ruajtje prej tij dhe nënshkruan në këto raste proces- verbalet përkatëse.
- Punonjësi i shërbimit të kontrollojë masat e sigurisë së objekteve si rrethimin, ndriçimin, gadishmërinë e sistemit të ndërlidhjes, mbrojtjes ndaj zjarrit dhe për çdo parregullsi të informojë me shkrim drejtuesit e shoqërisë.

Objekte që do të ruhen me Sistem elektronik, alarmi

Nr.	Emertimi i objektit që do ruhet me sinjal alarmi	Sistem alarmi
1.	<u>Zyrat e shërbimeve të Bashkisë objekt 4-katësh, kati i II pranë Shkollës Muzikës “Thoma Kalefi”</u> Shërbim i ruajtjes me 1 sistem alarmi me 3 sensore, sipas orareve: 16. ⁰⁰ -8. ⁰⁰ (e hënë-e premtë) 24 orë (e shtunë, e dielë dhe festa)	1 sisteme alarmi me aksesorët ndihmës
2.	<u>Magazina Ushqimore Qendra Sociale “Balashe”</u> Shërbim i ruajtjes me 1 sistem alarmi me 3 sensorë, të funksionojnë sipas orareve 22. ⁰⁰ -7. ⁰⁰ për cdo ditë (e hënë-e hënë)	1 sistem alarmi me aksesorët ndihmës
3.	<u>Magazina e ASH Publike, Ura e Shkumbinit</u> Shërbim i ruajtjes me 1 sistem alarmi me 2 sensorë, sipas orareve: 16. ⁰⁰ -8. ⁰⁰ (e hënë-e premtë) 24 orë (e shtunë, e dielë dhe festa)	1 sistem alarmi me aksesorët ndihmës
	Shuma	3

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

- Sistemet e Alarmit funksionojnë sipas orareve të parashikuara:
 1. Sistemi të realizohet në mënyrë të integruar për të gjitha shërbimet (sistem alarmi, GPS) në mënyrë që të bëjë sa më të lehtë dhe më fleksibël monitorimin nga operatorët e qendres kontrollit.
 2. Sistemet e Alarmit janë Sisteme teknologjike elektronike moderne për sinjalizimin e hyrjes apo dëmtimeve të paligjshme në ambientin e marrë në sigurim.
 3. Përgjegjësit e objekteve garantojnë aktivizimin dhe caktivizimin e alarmit në momentin e mbylljes dhe hapjes së objektit.
 4. Shoqëria e sigurisë mban përgjegjësi pas aktivizimit të sistemit të alarmit në rast se vjedhja apo dëmtimi i materialeve në objektin e siguruar ka ardhur si pasojë e neglizhencës së shërbimeve të kësaj shoqërie (pas ardhjes së sinjalit të alarmit në monitor si pasojë e mosvlerësimit dhe vonesës në verifikim)
 5. Montimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të sistemit të alarmit janë përgjegjësi e shoqërisë private të sigurisë.
 6. Sistemet e Alarmit të jenë me transmetim me GPRS, me sistem mbyllje me pult ose me tastier me kod, me sensorë me kabëll ose me ëireless.
 7. Të gjitha shpenzimet e mirëmbajtjes, për pjesë ndërrimi, paisjet e zëvendësuara, zëvendësimin e baterive, sensorë të ndryshëm, DVR, Centrale të sistemeve të alarmit, kabëll rrjeti etj, gjatë procesit të shërbimit do të mbulohen nga vetë shoqëria e sigurimit për gjithë kohën e parashikuar në kontratë.

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

Afatet e ekzekutimit:

Shërbimi i	Përshkrimi	Shuma	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit

Shtojca 8

(Shtojcë për t'u përfshirë nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

1. Shërbimi i Sigurimit me roje fizik dhe me sistem elektronik të objekteve në administrim të Bashkisë Elbasan dhe institucioneve të varesisë së saj.
2. Parandalimi, bllokimi, ndalimi dhe bashkëpunimi në zbulimin e rasteve të mundshme të vjedhjeve, demtimeve e shkatërtimeve të objekteve, prones dhe të pasurisë së Bashkisë Elbasan dhe institucioneve vartese.

Shpërndarja:

1. **Godina e Bashkisë Elbasan** do të sigurohet me një vend shërbimi dhe 3.78 punonjës shërbimi nga dita e hënë në të premte prej orës 16⁰⁰-08⁰⁰, të shtunë, të djelë dhe ditët e festave zyrtare do të sigurohet 24 orë (gjithsej 556 orë pune).
2. **Thertorja e Bashkisë Elbasan** do të sigurohet me një vend shërbimi dhe 3.78 punonjës shërbimi nga dita e hënë në të premte prej orës 16⁰⁰-08⁰⁰, të shtunë, të djelë dhe ditët e festave zyrtare do të sigurohet 24 orë (gjithsej 556 orë pune).
3. **Qendra Ekonomike e Arsimit** Bashkia Elbasan do të sigurohet me 1 (një) vend roje me 4.98 punonjës shërbimi me sistem 24 orësh (gjithsej 730 orë pune).
4. **Zyrat e Ndermarjes të Shërbimeve Publike** të Bashkisë Elbasan do të sigurohen me një vend shërbimi dhe 3.78 punonjës shërbimi nga dita e hënë në të premte prej orës 16⁰⁰-08⁰⁰, të shtunë, të djelë dhe ditët e festave zyrtare do të sigurohen 24 orë (gjithsej 556 orë pune).
5. **Teatri "Skampa"** Bashkisë Elbasan do të sigurohet me një vend shërbimi dhe punonjës shërbimi nga dita e hënë në të hënë prej orës 16⁰⁰-08⁰⁰ (gjithsej 488 orë pune) 3.32
6. **Muzeumi Bashkisë Elbasan** do të sigurohet me një vend shërbimi dhe 3.78 punonjës shërbimi nga dita e hënë në të premte prej orës 16⁰⁰-08⁰⁰, të shtunë, të djelë dhe ditët e festave zyrtare do të sigurohet 24 orë (gjithsej 556 orë pune).
7. **Galeria e Arteve** e Bashkisë Elbasan do të sigurohet me një vend shërbimi dhe 3.78 punonjës shërbimi nga dita e hënë në të premte prej orës 16⁰⁰-08⁰⁰, të shtunë, të djelë dhe ditët e festave zyrtare do të sigurohet 24 orë (gjithsej 556 orë pune).
8. **Oficina NSHP** e Bashkisë Elbasan do të sigurohet me një vend shërbimi dhe 3.78 punonjës shërbimi nga dita e hënë në të premte prej orës 16⁰⁰-08⁰⁰, të shtunë, të djelë dhe ditët e festave zyrtare do të sigurohet 24 orë (gjithsej 556 orë pune).
9. **Konvikti i Pedagogjikes** Bashkia Elbasan do të sigurohet me një vend shërbimi dhe 4.98 punonjës shërbimi me sistem 24 orësh (gjithsej 730 orë pune).
10. **Konvikti i Shkolles së Muzikës së Bashkisë Elbasan** do të sigurohet me një vend shërbimi dhe 3.78 punonjës shërbimi nga dita e hënë në të premte prej orës 16⁰⁰-08⁰⁰, të shtunë, të djelë dhe ditët e festave zyrtare do të sigurohet 24 orë (gjithsej 556 orë pune).
11. **Tregu Fruta Perimeve të qytetit** të Bashkisë Elbasan do të sigurohet me një vend shërbimi dhe 3.32 punonjës shërbimi nga dita e hënë në të hënë prej orës 16⁰⁰-08⁰⁰ (gjithsej 488 orë pune).
12. **Biblioteka Publike "Qemal Baholli"** e Bashkisë Elbasan do të sigurohet me një vend shërbimi dhe 3.78 punonjës shërbimi nga dita e hënë në të premte prej orës 16⁰⁰-08⁰⁰, të shtunë, të djelë dhe ditët e festave zyrtare do të sigurohet 24 orë (gjithsej 556 orë pune).

13. **Varezat e qytetit** të Bashkisë Elbasan do të sigurohen me një vend shërbimi dhe **3.32** punonjës shërbimi nga dita e hënë në të hënë prej orës 16.-08. **gjithsej 488 ore pune**
14. **Qendra Sociale “Balashe”**e Bashkisë Elbasan do të sigurohet me një vend shërbimi dhe **3.78** punonjës shërbimi nga dita e hënë në të hënë prej orës 16-08, të shtunë, të djelat dhe ditët e festive zyrtare do të sigurohet 24 ore. **gjithsej 556 ore pune**
15. **Qendra Komunitare e Romëve** e Bashkisë Elbasan do të sigurohet me një vend shërbimi dhe **3.32** punonjës shërbimi nga dita e hënë në të hënë prej orës 16⁰⁰-08⁰⁰ (**gjithsej 488 ore pune**)
16. **Objekti Zyrtar e furnaltës**, do të sigurohen me një vend shërbimi me **4.98** punonjës shërbimi me sistem 24 orësh (**gjithsej 730 orë**)
17. **Ndërmarrja Shërbimeve (Bordi Kullimit)** , do të sigurohet me një vend shërbimi dhe **3.78** punonjës shërbimi nga dita e hënë në të hënë prej orës 16⁰⁰-08⁰⁰, të shtunë, të djelat dhe ditët e festave zyrtare do të sigurohet 24 orë (**gjithsej 556 orë**).

Numri total i punonjësve = 66.02

Objekte që do të ruhen me Sistem elektronik, alarmi

Nr.	Emertimi i objektit që do ruhet me sinjal alarmi	Sistem alarmi
1.	<u>Zyrtar e shërbimeve të Bashkisë objekt 4-katësh, kati i II pranë Shkollës Muzikës “Thoma Kalefi”</u> Shërbim i ruajtjes me 1 sistem alarmi me 3 sensore, sipas orareve: 16. ⁰⁰ -8. ⁰⁰ (e hënë-e premte) 24 orë (e shtunë, e dielë dhe festa)	1 sistem alarmi me aksesoret ndihmës
2.	<u>Magazina Ushqimore Qendra Sociale “Balashe”</u> Shërbim i ruajtjes me 1 sistem alarmi me 3 sensorë, të funksionojnë sipas orareve 22. ⁰⁰ -7. ⁰⁰ për çdo ditë (e hënë-e hënë)	1 sistem alarmi me aksesoret ndihmës
3.	<u>Magazina e ASH Publike, Ura e Shkumbinit</u> Shërbim i ruajtjes me 1 sistem alarmi me 2 sensorë, sipas orareve: 16. ⁰⁰ -8. ⁰⁰ (e hënë-e premte) 24 orë (e shtunë, e dielë dhe festa)	1 sistem alarmi me aksesoret ndihmës
	Shuma	3

Vendi dhe dorezimi i shërbimeve: Prane çdo objekti, dorezimi i shërbimeve do të bëhet me proces verbal në prezencë të një përfaqësuesi të çdo institucioni dhe punonjësit të shërbimit.

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënues për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënues ose nuk ka qenë i dënues nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënues me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas Shtojcës 9.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim që ka paguar taksat dhe tarifat vendore per vitin 2021 për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifat vendore).

2.2.2 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2018, 2019 dhe 2020, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit që prokurohet.

2.2.3 Kopjet e çertifikuara të bilanceve për vitet 2018, 2019 dhe 2020 të paraqitura në autoriteteve përkatëse, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së fondit limit, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislativës në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Akti i Miratimit të Qendrës së Kontrollit, miratuar nga Policia e Shtetit në Qarkun ku ushtron aktivitetin SHPSF si dhe Dokumenti i Performances mbi mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të operatorit ekonomik.

Per kete duhet te paraqese **vertetim nga Drejtoria e Policise se Qarkut** ku jepet informacioni i mesiperme i kerkuar. **Vertetimi duhet te jete leshuar ne vitin 2020**, persa i perket performancës është e nevojshme të përfshihen të dhënat si mëposhtë:

4 (kater) pergjegjesa sherbimi

5 (pese) operatore ne qendren e kontrollit/sallen operative

12 (dymbedhjete) persona per grupin e gatshem

Secili nga keta punonjes te disponoje deshmita perkatese.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht **69 punonjës** të siguar nga të cilët 67 punonjës shërbimi roje, një drejtues teknik dhe administratorin, e për këtë operator duhet të paraqesë:

Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguar për 2 muajt e fundit (Prill 2021- Maj 2021), shoqëruar me **listëpagesat e sigurimeve shoqërore** (formularët E-sig 025) të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike.

2.3.4 Autorizim Individual në emër të shoqërisë për përdorimin e frekuencave për radiokomunikim dhe alarm të lëshuar nga AKEP në zbatim të ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, me zonë mbulimi Bashkia Elbasan.

2.3.5 Ofertuesi duhet të disponojë se paku **2 automjete** për ndërhyrje në raste emergjente, në pronësi të shoqërisë apo të marre me qera. Për këtë operator ekonomik duhet të paraqesë:

- Leje e Qarkullimit dhe taksat e automjetit në pronësi të shoqërisë .

Në rastin kur automjeti është marre me qera, Leja e Qarkullimit duhet të shoqërohet edhe me Kontraten noteriale të marrjes me qera, ku të jetë përcaktuar afati dhe qelimi i marrjes me qera.

2.3.6 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin **analizen e kostos për ofertën e paraqitur**.

2.3.7 Licensë e shoqërisë për ushtrimin e aktivitetit të “Shërbimit të ruajtjes dhe/ose sigurisë fizike”, **nënkategoria 1.3.A**, “Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private si dhe veprimtarive social kulturore, sportive fetare e politike”, lëshuar nga QKL;

2.3.8 Çertifikatë e drejtuesit teknik të subjektit, e vlefshme për ushtrimin e veprimtarisë së ruajtjes dhe të sigurisë fizike për nënkategorinë 1.3.A;

2.3.9 Çertifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave për të paktën 67 punonjës shërbimi të lëshuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Elbasan.

2.3.10 Operatori Ekonomik duhet të ketë në pronësi jo më pak se 17 arme, të këtyre autorizimin dhe dokumentacionin përkatës për blerje arme, të lëshuar nga një subjekt i licensuar.

2.3.11 Operatori Ekonomik te kete jo me pak se 30 persona te paisur me leje per perdorim arme.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 10

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik:

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:			
• Informacione për nënkontraktorin			
Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

--	--	--	--

• **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm

<p>për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p>	<p>në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <hr/> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1	_____

të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:	
1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklaratë;	Po []
2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;	Po []
3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;	Po []
4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;	Po []
5. Për efekt të kësaj deklaratë dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që: a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor; b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës .	Po []
6. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;	Po [] Jo []
7. Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi	Po [] Jo []

<p>deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).</p>	
<p>8. Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:</p> <p>a) çmimet;</p> <p>b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;</p> <p>c) qëllimin ose vendimin për të paraqitur një ofertë ose jo; ose</p> <p>d) paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës.</p>	<p>Po [] Jo []</p>
<p>9. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, marrëveshje ose kontratë me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet ose dërgesat specifike të mallrave ose shërbimeve në lidhje me prokurimin përkatës, përveç kur thuhet në pikën 7 më lart.</p>	<p>Po [] Jo []</p>
<p>10. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të ditura ose treguar ofertuesve të tjerë në asnjë mënyrë, qoftë para datës dhe orës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes së ofertës fituese dhe nënshkrimit të kontratës, përveç nëse kërkohet nga ligji ose nëse thuhet specifikisht nën pikën 7 më lart.</p>	<p>Po [] Jo []</p>
<div style="border: 1px solid black; height: 50px;"></div>	

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2022 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:	
1. Operatori ekonomik garanton mbrojtjen e së drejtës për punësim dhe profesion nga çdo formë e diskriminimit parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.	Po [] Jo []
2. Operatori ekonomik ka kontratat përkatëse të punës me punonjësit e tij dhe garanton masa sigurie dhe shëndetësore për të gjithë dhe, në veçanti, për grupet në nevojë, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.	Po [] Jo []
3. Operatori ekonomik nuk ka ndonjë masë efektive ligjore të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale (ISHPSHSH). Në rastet kur janë identifikuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.	Po [] Jo []

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike dhe termat e referencës, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e shërbimeve dhe grafikun e ekzekutimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
-----------	-----------

<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:</p> <p>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.</p>	<p><u>Punonjës</u></p> <p>Po [] Jo []</p> <p>Nëse, po, numri i punonjësve:</p> <hr/> <p>Profili i punonjësve</p> <hr/> <p><u>Makineri e mjete</u></p> <p>Po [] Jo []</p> <p>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</p> <hr/>
<p>Data e dorëzimit të deklaratës _____ Vula _____</p> <p>Emri, Mbiemri, Firma _____</p>	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një **Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.**
- Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, **një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit** duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë të informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

Shenim: Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Shtojca 11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

Formulari i Njoftimit të Skualifikimit²

[Vendndodhja dhe data]

[Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor]

[Adresa e Ofertuesit]

I nderuar, Z. / Znj. <Emri i kontaktit >

Ju falënderojmë për pjesëmarrjen tuaj në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit publik. Procedura u zhvillua në përputhje me Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes në bazë të kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informojmë se jeni skualifikuar pasi oferta e paraqitur nga ju është refuzuar për arsyen (et) e mëposhtme:

Nëse mendoni se autoriteti/enti kontraktor ka shkelur LPP-në ose RPP-në gjatë procedurës së prokurimit publik, ju keni të drejtë të inicioni një procedurë rishikimi pas publikimit të njoftimit të fituesit sipas parashikimeve të Ligjit të Prokurimit Publik.

Megjithëse nuk mund t'i përdorim shërbimet tuaja në këtë rast, ne besojmë se do të mbeteni të interesuar për iniciativat tona të prokurimit.

Me respekt,

Titullari i Autoritetit/Entit Kontraktor

²Ky njoftim do të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit të zhvilluara në rrugë shkresore

Shtojca 12

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data]

Drejtuar: [Emri dhe adresa e Ofertuesit fitues]

Procedura e prokurimit/lotit

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [Objekti, Sasitë dhe kohëzgjatja e kontratës] Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-t Vlera (e shprehur në shifra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it Vlera (e shprehur në shifra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it arsyet

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it arsyet

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

[Titullari i Autoritetit /Entit kontraktor]

Shtojca 13

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në rastin e Marrëveshjes Kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Drejtuar: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të suksesshëm]

1. _____

2. _____

3. _____

* * *

Procedura e prokurimit:

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [shuma, objekti, kohëzgjatja e kontratës, etj.]

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) _____

(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) _____

e shprehur në shifra dhe në fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

arsyet

Seksioni III Termat dhe Kushtet e Kontratës (TKK)

Ky Seksion përmban :

Shtojca 14: Kushtet e Përgjithshme të Kontratës

Shtojca 15: Kushtet e Vecanta të Kontratës

Shtojca 16: Formulari i Sigurimit të Kontratës

Shtojca 17: Draftmarreveshja ku përcaktohen të gjitha kushtet

Shtojca 18: Draftmarreveshja ku nuk përcaktohen të gjitha kushtet

Shtojca 14

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPK)

Këto Kushte të Përgjithshme të Kontratës (KPK), së bashku me Kushtet e Veçanta dhe dokumentet e tjera të renditura në to, përbëjnë një dokument të plotë që shpreh të drejtat dhe detyrimet e palëve.

Neni 1 Dispozitat e përgjithshme

1.1 Përkufizimet

Në Kushtet e Kontratës ("këto Kushte"), të cilat përfshijnë Kushtet e Veçanta dhe këto Kushte të Përgjithshme, fjalët dhe shprehjet e mëposhtme kanë këto kuptime:

1.1.1 Kontrata

- 1.1.1.1 "Kontrata" do të thotë kontrata me shpërblim, e lidhur me shkrim, ndërmjet një apo më shumë operatorëve ekonomikë dhe një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore, që kanë si objekt kryerjen e punimeve, furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, në përputhje me LPP.
- 1.1.1.2 "Dokumentet e Kontratës" do të thotë dokumentet e renditura në Kontratë, përfshirë çdo ndryshim të saj.
- 1.1.1.3 "Çmimi i Kontratës" do të thotë çmimi që i paguhet Furnizuesit siç specifikohet në kontratë.
- 1.1.1.4 "Përfundimi" do të thotë përmbushja e të gjitha detyrimeve, me ose pa penalitete, nga Furnizuesi në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në Kontratë.
- 1.1.1.5 "Ndërpërje e Kontratës" do të thotë mosvijimi i ekzekutimit të Kontratës sipas përcaktimeve në Nenin 23.
- 1.1.1.6 "Specifikime teknike" do të thotë karakteristikat e Shërbimeve objekt kontrate dhe çdo shtesë dhe modifikim i këtyre karakteristikave në përputhje me Kontratën.
- 1.1.1.7 "Termt e Referencës" shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.
- 1.1.1.8 "Listat" do të thotë dokumenti (et) me titull Listat të plotësuara nga Furnizuesi dhe të dorëzuara me ofertën, siç janë të përfshira në Kontratë. Dokumente të tilla mund të përfshijnë Listat e Çmimeve të dhëna, Listat e tarifave dhe / ose çmimeve.
- 1.1.1.9 "Ofertë" do të thotë oferta ekonomike dhe të gjitha dokumentet e tjera që Furnizuesi ka dorëzuar me ofertën ekonomike, siç janë përfshirë në Kontratë.
- 1.1.1.10 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.
- 1.1.1.11 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

1.1.2 Palët e Kontratës

- 1.1.2.1 "Palë" do të thotë nënshkruesit e kontratës, në cilësinë e Blerësit dhe Furnizuesit sipas kontekstit.
- 1.1.2.2 "Blerës" do të thotë Autoriteti/Enti Kontraktor përfituesi i Shërbimeve objekt kontrate.
- 1.1.2.3 "Furnizues" do të thotë operatori (ët) ekonomik që kryen furnizime objekt kontrate.
- 1.1.2.4 "Nënkontraktor" do të thotë çdo subjekt i caktuar si nënkontraktor për kryerjen e një pjese të Shërbimeve.
- 1.1.3 Llogaritja e afateve
 - 1.1.3.1 "Ditë" do të thotë një ditë kalendarike.
- 1.1.4 Shërbime
 - 1.1.4.1 "Shërbime" do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga furnizuesi sipas kontratës.
- 1.1.5 Përkufizime të tjera

-
- 1.1.5.1** "Adresa e Blerësit" është adresa e specifikuar në KVK.
- 1.1.5.2** "Forca Madhore" është përcaktuar në Nenin 20 "Forca Madhore".
- 1.1.5.3** "Sigurimi i Kontratës" është sipas përcaktimeve të Nenit 11 "Sigurimi i Kontratës".
- 1.1.5.4** "Vendi i kryerjes së shërbimeve", do të thotë vendi i përcaktuar në KVK.
- 1.1.5.5** "E paparashikueshme" ose "E paparashikuar" do të thotë një ngjarje objektivist e pamundur të parashikohet në momentin e publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE.
- 1.1.5.6** Modifikimi i kontratës" është sipas përcaktimeve në Nenin 21.
- 1.1.5.7** "Legjislacioni në fushën e prokurimit" do të thotë LPP-ja, Rregullat e Prokurimit Publik dhe akte të tjera nënligjore në bazë dhe për zbatim të LPP –së siç specifikohet në KVK
- 1.1.5.8** "Praktikat e Ndaluar" kanë kuptimin e përcaktuar në LPP.

1.2 Interpretimi

1.2.1 Interpretimi i Kontratës, përveç kur konteksti kërkon ndryshe:

- (a) fjalët që tregojnë një gjini përfshijnë të gjitha gjinitë;
- (b) fjalët që tregojnë njëjës përfshijnë edhe shumësin dhe fjalët që tregojnë shumësin përfshijnë edhe njëjës;
- (c) dispozitat që përfshijnë fjalën "bie dakord", "rënë dakord" ose "marrëveshje" kërkojnë që marrëveshja të dokumentohet me shkrim;
- (d) "i shkruar" ose "me shkrim" do të thotë i shkruar me dorë, i shkruar me makinë, printuar ose i bërë në mënyrë elektronike.

1.2.2 Modifikimi

Çdo modifikim i Kontratës i cili nuk kryhet me shkrim, dhe nuk përmban datën, apo nuk i referohet shprehimisht Kontratës dhe nuk nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar rregullisht i secilës Palë është i pavlefshëm. Palët nuk mund të bëjnë modifikime të asnjë elementi të kontratës që do të sillnin ndryshime thelbësore në kushtet mbi bazën e të cilave është përzgjedhur Furnizuesi.

1.2.3 Heqja dorë

Çdo heqje dorë nga të drejtat, kompetencat ose mjetet ligjore të një Pale sipas Kontratës duhet të bëhet me shkrim, me datë dhe e nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Palës që bën këtë dorëheqje, dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën nga e cila po hiqet dorë.

